



KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 61, datë 06.06.2017

“PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN NGA SHOQËRIA AKSIONARE “ECO TIRANA SHA” PËR MUNDËSINË E INVESTIMIT APO ÇFARËDO LLOJ FORME OPERIMI ME SHOQËRI TË TJERA TREGTARE”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1.1, shkronja b) dhe pika 1.6 shkronja b), nenit 54 shkronja k) dhe nenit 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Shoqëria aksionare “ECO TIRANA sha” në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, të shqyrtojë, vlerësojë dhe negociojë në lidhje me mundësinë e investimit apo çfarëdo lloj forme operimi me shoqëri të tjera tregtare, në një nga mënyrat e parashikuara nga legjislacioni “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
2. Në rast se nga ana e shoqërisë “ECO TIRANA sha” do të arrihet në një vendimarrje konkrete sipas pikës 1 të këtij vendimi, realizimi i përfundimit të kësaj procedure do të bëhet vetëm pasi të jetë analizuar situata financiare dhe juridike e shoqërisë me të cilën vendos të hyjë në marrëdhënie tregtare.
3. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë ose personin e deleguar prej tij, që të përfaqësojë Bashkinë e Tiranës, në raport me aksionet që zotëron Bashkia Tiranë, në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë “ECO TIRANA sha”, për kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI